

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 1</i>

METODOLOGJIA E TAKSAVE TË KYÇJES NË RRJETIN E TRANSMISIONIT

Versioni 2.6

Nëntor 2010

Prishtinë

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 2</i>

Përmbajtja

1	Hyrje	3
1.1	Qëllimi	3
1.2	Shtirja.....	3
1.3	Kërkesat Ligjore.....	3
1.4	Definicionet.....	4
2	Detajet e Kërkesave Juridike	7
2.1	Referencat dhe Ligji Mbizotërues.....	7
2.2	Ligjet për Energjinë	7
2.3	Ligji për Rregullatorin e Energjisë	7
2.4	Rregulli për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.....	8
2.5	Kodi i Kyçjes	8
2.6	Metodologjia e Tarifave për Sektorin e Enenergjisë Elektrike	8
3	Parimet e llogaritjes së taksave	9
3.1	Çështje të Përgjithshme.....	9
3.2	Metodologjia Hibrid.....	9
3.3	Kyçjet Emergjente	12
3.4	Operimi dhe Mirëmbajtja.....	12
3.5	Standardet e Kyçjes.....	13
3.6	Asetet Direkte dhe të Veçanta të Kyçjes.....	13
3.7	Përforcimi i Infrastrukturës	13
3.8	Përgjegjësit e Kyçjes dhe Tarifat	14
4	Çështjet e Implementimit	15
4.1	Trajtimi i Barabartë.....	15
4.2	Konfidencialiteti	16
4.3	Diskutimet Preliminare dhe Studimet e Dizajnit	16
4.4	Publikimi i Kostos.....	16
4.5	Aplikimi për Kyçje	16
4.6	Studimi i Dizajnit.....	17
4.7	Taksa e Kyçjes	17
4.8	Oferta për Kyçje.....	18
4.9	Marrëveshja për Kyçje.....	18
4.10	Refuzimi për Kyçje	19
4.11	Dështimi i Kyçjes.....	19
4.12	Avancimet e Kyçjes (Rritja e kapacitetit)	19
4.13	Asetet e Paguara nga Donatorët	19
4.14	Zbritjet.....	20
4.15	Anulimi (Përfundimi) i Kyçjes	20
4.16	De-energizimi	20
4.17	Ankesat	20
	Shtojca 1: Shembujt përmes Figurave të Kyçjeve të Reja	21
	Shtojca 2: Forma e Aplikacionit për Kyçje.....	24
	Shtojca 3: Taksa për Aplikim, Tarifa Standarde dhe Kostoja Inxhinierike.....	28

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit <i>ver. 2.6</i>	DT-KO-001 <i>faqe 3</i>
---	---	-----------------------------------

1 Hyrje

1.1 Qëllimi

Ky dokument përcakton metodologjinë, sipas së cilës tarifohen **Kyçjet e Reja**, plotësimet apo rritja e kapacitetit në kyçjet ekzistuese, në Sistemin e Transmisionit për shpenzimet që ndërlidhen me realizimin e kyçjes.

1.2 Shtrirja

Ky dokument përmban:

1. Trajtimin dhe parimet e taksave për kyçjet e reja në rrjetin e transmisionit
2. Definimin e **Aseteve Direkte, Aseteve të Infrastrukturës së Re, Aseteve për Përforsim të Infrastrukturës**
3. Ndarjen e kostos (shpenzimeve) së **Aseteve Direkte, Aseteve të Infrastrukturës së Re, Aseteve për Përforsim të Infrastrukturës**
4. Kalkulimin e **Taksës për Aplikim**
5. Taksën për mirëmbajtje dhe operim
6. **Ofertën për kyçje** dhe Marrëveshjen për Kyçje
7. Anulimin e procesit të aplikimit për kyçje; dhe
8. Ankesat

Ky dokument nuk trajton çështjet e detajuara teknike që lidhen me standardet teknike të pajisjeve, operimit dhe planifikimit të kyçjeve të reja, etj – këto janë të mbuluara në Kodin e Kyçjes të Kodit të Rrjetit si dhe nga kërkesat prej kodeve tjera teknike në fuqi.

1.3 Kërkesat Ligjore

Kjo metodologji merr në konsideratë dhe kur është e nevojshme zbaton kërkesat e Ligjit për Energjinë Nr. 2004/10 dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.2004/9.

Neni 4.3 (l) dhe (m) i Rregullit për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji imponon obligim për **KOSTT** që të përgatisë, dorëzojë për aprovim dhe publikoj në ueb faqen e vet “Metodologjinë e Taksave për Kyçje” për **kyçjet e reja** dhe modifikimin e kyçjeve ekzistuese në rrjetin e transmisionit. Sipas dispozitave të Nenit 6.1 të këtij rregulli, Metodologjia e Taksave për Kyçje (i referohet Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit) dhe procedurat e ndërlidhura duhet të përputhen me Rregullin e miratuar nga **ZRrE** “Metodologjia e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Prandaj, ky dokument duhet të revidohet kurdo që ndryshon Metodologjia e Tarifave.

Neni 6.7 i Kodit të Kyçjes, kërkon nga **KOSTT** që të zhvilloj Metodologjinë e Taksave për Kyçje dhe Procedurat në përputhshmëri të plotë me parimet e përgjithshme të Metodologjisë së Taksave për Kyçje, siç janë përcaktuar në “Rregullin për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji”. Sipas Licencës për Operator të Sistemit të Transmisionit ky dokument duhet të publikohet në ueb faqen e **KOSTT**-it.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 4</i>

1.4 Definicionet

Çdo definicion i cili nuk është i renditur këtu mund të gjendet në Ligje, Kodin e Rrjetit, Rregullat e Tregut, Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike ose Rregullin për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Termet e definuara:

Taksa për Aplikim është pagesa që kryhet në kohën kur aplikohet për kyçje, e cila mbulon shpenzimet për: **Studimin e Dizajnit, Koston Fillestare** dhe draftimin e Marrëveshjes për Kyçje. Gjatë diskutimeve fillestare me palën aplikuese para se të bëhet Aplikimi për Kyçje, **KOSTT** do të përcakton numrin e ditëve të nevojshme për procedimin e Aplikacionit.

Jetëgjatësia e Aseteve është jetëgjatësia e definuar e aseteve të transmisionit sikurse është përcaktuar nga **ZRrE** për qëllim të kalkulimit të tarifave, e cila është 35 vite.

Kostoja për Kompenzim janë kostot që duhet të paguhen nga **Aplikuesi** për pronarin e tokës, për qasje në tokë dhe për dëmet eventuale gjatë implementimit të projektit

Aplikuesi është pala ose pala e mundshme që është e interesuar, ka aplikuar ose është në proces të kyçjes në rrjetin e transmisionit.

Shfrytëzues apo **Përdorues** nënkupton palën që është në shfrytëzim të aseteve të Sistemit të Transmisionit.

Aplikacioni për Kyçje është aplikacion i dorëzuar nga **Aplikuesi** për një kyçje të re apo rritje të kapacitetit të kyçjes së vjetër në Rrjetin e Transmisionit.

Forma e Aplikacionit për Kyçje është formë e aplikacionit për kyçje për gjenerator, ngarkesë respektivisht konsumator të kualifikuar sikurse paraqitet në Shtojcën 2.

Kapaciteti i Kyçjes nënkupton kapacitetin elektrik të matur në MVA i ofruar në ofertën për kyçje.

Data e Kyçjes është data në të cilën Asetet e Kyçjes janë apo konsiderohet të jenë plotësisht të kyçura në Rrjetin e Transmisionit dhe **KOSTT** është në gjendje të siguroj Kapacitetin për Kyçje.

Oferta për Kyçje është një ofertë për kyçje në Rrjetin e Transmisionit e dhënë nga **KOSTT** brenda 30 ose 90 ditëve nga Aplikimi për Kyçje.

Pala Përgjegjëse për Kyçje është pala që mund të jetë **Aplikuesi** ose **KOSTT** që merr përgjegjësitë e definuara sipas Nenit 3.8 të kësaj Metodologjie.

Studimi i Dizajnit paraqet një studim mbi mundësitë (opsionet) e kyçjes në rrjetin e transmisionit, të përgatitur nga **KOSTT** për një **Aplikues** pas dorëzimit të **Aplikacionit për Kyçje** nga ana e **Aplikuesit**.

Asetet Direkte të Kyçjes ose Asetet Direkte janë asetet që janë drejtpërdrejtë të ndërlidhura me ndonjë Ofertë të caktuar për Kyçje. Këto asete përfshijnë të gjitha

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit <i>ver. 2.6</i>	DT-KO-001 <i>faqe 5</i>
---	---	-----------------------------------

elementet prej terminaleve të tensionit të lartë (TL) të transformatorëve deri tek **Asetet e Infrastrukturës së Re**.

Kostoja Inxhinierike është kostoja që paguhet nga **Aplikuesi** për **KOSTT**, varësisht prej përgjegjësisë dhe aktiviteteve të tij për procesin e tenderimit dhe ndërtimit të kyçjes, dhe si e tillë do të kalkulohet si:

1.5% e koston së **Aseteve të Tensionit të Lartë** kur **Aplikuesi** është **Pala** përgjegjëse për Kyçje,

5% e koston së **Aseteve të Tensionit të Lartë** kur **KOSTT** është **Pala** përgjegjëse për Kyçje

ZRrE nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji

Studimi i Fizibilitetit është studim i detajuar mbi çështjet teknike dhe ekonomike bazuar në kalkulimet teknike të projektit të caktuar që do të realizohet nga një palë e kontraktuar për shkak të madhësisë dhe kompleksitetit të projektit.

Baza e Aseteve të Infrastrukturës janë asetet e transmisionit të **KOSTT**-it ku **Aplikuesi** apo donatori nuk ka paguar për asetet dhe që janë baza e asetëve për të cilat **KOSTT** është i lejuar që të ngarkoj me pagesë shfrytëzuesit për asetet e infrastrukturës mbi koston e operimit dhe mirëmbajtjes,

KEK nënkupton Korporatën Energjetike të Kosovës

KOSTT nënkupton Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës

Asetet e Infrastrukturës së Re janë asetet që ndërlidhin Asetet Direkte me asetet ekzistuese të sistemit.

Asetet Përforcuese të Infrastrukturës janë asetet e nevojshme për përforcim të rrjetit të transmisionit të domosdoshme për realizimin e kyçjes përkatëse

Asetet e Tensionit të Lartë përfshijnë **Asetet Direkte, Asetet e Infrastrukturës së Re dhe Asetet Përforcuese të Infrastrukturës**

Kostoja Fillestare është një vlerësim i koston së asetëve i bazuar në njohuritë e **KOSTT**-it për koston aktuale për blerjen, ndërtimin, instalimin, testimin, lëshimin në punë, dhe mbikëqyrjen e **Aseteve të Tensionit të Lartë**

Vlera e Aseteve Ekuivalente Moderne (MEAV) është kostoja aktuale e zëvendësimit të asetit të transmisionit. Kjo përdoret në kalkulimin e tarifës për operim dhe mirëmbajtje.

Kyçje e Re është linjë, gjenerator, nënstacion, stabiliment shpërndarës i kyçur në Rrjetin e Transmisionit ekzistues në pikën/nyjën kyçëse e definuar me MVA në nivelin nominal të tensionit.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 6</i>

Vlera Neto e Aseteve është **MEAV** e zbritur (skontuar) nga pagesat e rregulluara të bëra nga Aplikuesi (**NAV**).

Afati i fundit për Ofertë është numri i ditëve pas dorëzimit të **Aplikacionit për Kyçje**, brenda të cilave **KOSTT** duhet të dorëzoj **Ofertën për Kyçje**.

Baza e Aseteve për Operim dhe Mirëmbajtje janë të gjitha asetet e transmisionit të **KOSTT** që paraqesin bazën e asetëve për të cilat **KOSTT** është i lejuar të tarifoj për operim dhe mirëmbajtje përmes tarifave TUoS. Varësisht nga Rregullatori, për qëllim të tarifës për O&M, **Asetet e Tensionit të Lartë** mund të bëhen pjesë e Bazës së Aseteve për Operim dhe Mirëmbajtje.

Tarifë Standarde është tarifa e miratuar nga **ZRrE** dhe publikuar në faqen elektronike të **KOSTT**-it në €/ditë, për punët e kryera nga stafi i **KOSTT**-it.

Plani Zhvillimor i Transmisionit nënkupton referencën tek Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit, në dokumentet tjera.

	<p align="center">Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit</p>	<p align="center">DT-KO-001</p>
	<p align="center"><i>ver. 2.6</i></p>	<p align="center"><i>faqe 7</i></p>

2 Detajet e Kërkesave Juridike

2.1 Referencat dhe Ligji Mbizotërues

Në vazhdim renditen referencat në Nene të Ligjeve, rregulloreve, kodeve dhe metodologji të relevante. Në rast të ndonjë mospajtimit në mes të dispozitave ligjore të referuara dhe interpretimeve në kuadër të kësaj metodologjie, do të mbizotërojnë dispozitat ligjore.

2.2 Ligjet për Energjinë

Ligji për Energjinë përcakton kushtet për funksionimin e gjenerimit, transmisionit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, importit, eksportit dhe transitit të energjisë, organizimit të qasjes në rrjeta, dhe organizimin e tregut të energjisë.

Neni 26 i Ligjit për Energjinë Elektrike, lidhur me Qasjen e Palëve të Treta, e obligon **KOSTT**-in që të lejojë qasje në rrjetin e transmisionit mbi bazën e rregullave dhe rregulloreve relevante në fuqi.

Veç kësaj Neni 26 lejon refuzimin e qasjes në rastet kur ka mungesë të kapacitetit të nevojshëm, dhe **kyçja e re** do të rrezikonte sigurinë e furnizimit. Neni i njëjtë i jep të drejtën çdo pale të refuzuar që të ankohet për këtë në **ZRrE**. Refuzimi i qasjes nuk do të thotë domosdoshmërisht refuzimin e kyçjes, si shembull është asetet e kyçjes prej 100 MW të cilët janë limituar në **Ofertën për Kyçje** në 25 MW për shkak të restriksioneve në tension më të lartë.

Neni 30 i Ligjit për Energjinë Elektrike, siguron bazën ligjore për kyçje të konsumatorit – ngarkesës (konsumit) së re ose prodhuesit në rrjetin e transmisionit sipas disa kushteve të caktuara. Termet dhe kushtet për kyçje në rrjetin e transmisionit janë të specifikuar në kuadër të Kodit të Rrjetit.

2.3 Ligji për Rregullatorin e Energjisë

Ligji për Rregullatorin e Energjisë themelon Zyrën e pavarur të Rregullatorit të Energjisë dhe definon kompetencat e saj, detyrat dhe funksionet në mesin e të cilave edhe kriteret për rregullimin e çmimeve.

Kapitulli 9 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë mbulon çështjet që kanë të bëjnë me mandatin e **ZRrE**-s lidhur me Rregullimin e Çmimeve. Taksat për kyçje bien përbrenda kornizës së çmimeve të rregulluara, prandaj, Metodologjia e Tarifave e aprovuar, në mes tjerave përmban po ashtu parimet e taksave të kyçjes. Ky dokument është plotësisht në pajtim me këto parime.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 8</i>

2.4 Rregulli për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

Në ndërlidhje me Metodologjinë e Taksave për Kyçje, Rregulli për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji definojnë termet dhe kushtet e parimeve për kyçje në sistem si dhe parimet dhe elementet e Marrëveshjes për Kyçje.

Neni 4 i Rregullit për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji definojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve lidhur me kyçjen në sistem. Ky Rregull ofron parimet e përgjithshme të Metodologjisë së Taksave për Kyçje, kërkesat për përputhshmëri me Metodologjinë e Tarifave të **ZRrE**, dispozitat për mos-diskriminim etj. Neni 8.6 paraqet bazën për tarifimin (ngarkimin) e kyçjeve ekzistuese për rritjen e kapacitetit apo modifikimit të kyçjeve të tyre.

2.5 Kodi i Kyçjes

Kodi i Kyçjes është pjesë e Kodit të Rrjetit dhe mbulon kërkesat inxhinierike dhe teknike të kyçjes. Gjithashtu kërkon nga **KOSTT** që të caktojë Metodologjinë e Taksave për Kyçje dhe të jap **Oferta për Kyçje**.

Pas pranimit të **Ofertës për Kyçje** duhet të lidhet Marrëveshja për Kyçje. Kodi i Kyçjes po ashtu definojnë përmbajtjen teknike të kësaj marrëveshje.

2.6 Metodologjia e Tarifave për Sektorin e Eneergjisë Elektrike

Neni 5 i Metodologjisë së Tarifave për Sektorin e Eneergjisë Elektrike definojnë parimet themelore të Metodologjisë së Taksave për Kyçje. Në mënyrë që të implementohet metodologjia është e domosdoshme të caktohet kufiri në mes të aseteve të financuara nga taksat për kyçje dhe atyre të financuara nga tarifat e TUoS. **ZRrE** synon që **KOSTT**-i të miratojë taksën e Aseteve për përfundim të infrastrukturës, duke i mundësuar rikthimin e kostos totale kapitale të kyçjes si dhe koston e kapitalizuar të operimit dhe mirëmbajtjes. Kur Aplikuesi i ri përdor asetet e **Shfrytëzuesëve** të më hershëm (ekzistues), Shfrytëzuesit ekzistues duhet t'i kompensohen disa nga kostot nga Aplikuesi i ri. Pagesa duhet të bëhet përnjëherë para fillimit të punës.

Metodologjia e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike mund të ndryshojë kohë pas kohe dhe kur ndonjë ndryshim i këtij dokumenti aprovohet, atëherë këto ndryshime duhet të përfshihen edhe në Metodologjinë e taksave të Kyçjes.

Në mënyrë që të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e Metodologjisë së Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike në këtë dokument **KOSTT** paraqet të ashtuquajturin modelin “hibrid” të taksës për kyçje, që mund të konsiderohet si taksë për kyçje pjesërisht e thellë. Seksionet në vijim ofrojnë më shumë detaje lidhur me këtë metodologji.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 9</i>

3 Parimet e Llogaritjes së Taksave

3.1 Çështje të Përgjithshme

Në mënyrë që të përmbush të gjitha kërkesat ligjore si dhe sugjerimet e arsyeshme nga palët e involvuara, **KOSTT** ka përgatitur Metodologjinë e Taksave për Kyçje pjesërisht të thellë ose të ashtuquajtur modelin hibrid për taksimin e **kyçjes së re** në Rrjetin e Transmisionit. Ndërsa palët që ndryshojnë apo rrisin kapacitetin e tyre në kyçjet ekzistuese, sipas disa standardeve të caktuara do të kenë trajtimin e njëjtë dhe kjo metodologji do të jetë plotësisht e zbatueshme.

Para përshkrimit të modelit hibrid, është e nevojshme të kuptohen bazat e taksës së cekët dhe të thellë.

- a. Me **taksë për kyçje të cekët**, **Aplikuesi** do të ngarkohet për të gjitha kostot e ndërlidhura me kyçjen e tij. Do të thotë, do të paguaj vetëm kostot e ndërlidhura me prokurimin dhe instalimin e **Aseteve Direkte**, pavarësisht se kyçja kërkon përf forcime të thella ose përf forcim të infrastrukturës në sistemin ekzistuese.
- b. **Taksa për kyçje të thellë** përfshinë pagesën nga **Aplikuesi** për të gjitha kostot e ndërlidhura me kyçjen, duke përfshirë koston për **Asetet Direkte**, koston për **Asetet e Infrastrukturës së Re** dhe koston e **Aseteve për Përf forcim të Infrastrukturës** ekzistuese të sistemit.


3.2 Metodologjia Hibrid

Varësisht nga vendi (shteti) ose specifikat e sistemit elektroenergjetik, aplikohen taksa dhe metodologji të ndryshme: plotësisht të thella, pjesërisht të thella, hibrid sipas parimeve të ndryshme, krejtësisht të cekëta, etj.

Modeli hibrid i përzgjedhur nga **KOSTT**, është i ngjashëm me disa modele pjesërisht të thella që zbatohen në Evropë, megjithatë ka disa dallime. Kjo Metodologji dallon në parimet e taksës për kyçje sipas të cilës ngarkohen dhe paguajnë Gjeneruesit (Gj) nga ato me të cilat ngarkohen dhe paguajnë ngarkesat (N).

- Gjeneratorët do të paguajnë **taksën për kyçje të thellë**, që do të thotë se do të paguajnë për të gjitha: **Asetet Direkte**, **Asetet e Infrastrukturës së Re** dhe **Asetet për përf forcimin e Infrastrukturës** ekzistuese të sistemit.
- Ngarkesa do të tarifohet si kyçje e thellë vetëm kur kyçja e tyre e planifikuar nuk është në përputhje me Planin Zhvillimor të Transmisionit. Në raste kur kyçja e ngarkesës është paraparë dhe është pjesë e Planit të aprovuar Zhvillimor të Transmisionit, do të aplikohet **taksa për kyçje të cekët** dhe **Aplikuesi** do të financojë **Asetet Direkte**, kurse **Asetet e Infrastrukturës së Re** dhe **Asetet për përf forcim të Infrastrukturës** ekzistuese të sistemit do të financohen nga **KOSTT** përmes tarifave TUoS.

Fig. 1 Modeli Hibrid



E meta e këtij modeli është ndryshimi që implikojnë në mes të Gj dhe N, megjithatë mbetet përbrenda kornizës së mos-diskriminimit të **Aplikuesëve** të të njëjtës kategori. Në anën tjetër, përparësia e madhe e modelit hibrid është sepse stimulon një zhvillim të planifikuar të ngarkesës së kyçur në Sistemin e Transmisionit.

Figurat shembuj janë dhënë në Shtojcën 1.

Vendimi për aplikimin e taksës hibrid për kyçje, posaçërisht kur zbatohet taksa për kyçje të thellë, ka implikime të ndryshme. Dy kryesoret janë:

- Procesi është kronologjik që do të thotë se në të ardhmen ne nuk do të mund të shikojmë vetëm në grup asetesh dhe përcaktojmë se cilat janë asete të sistemit, të kyçjes së thellë ose asete të kyçjes së cekët – kjo do të varet nga renditja sipas të cilit janë ndërtuar dhe paguar.

Në vijim janë dy figura shembuj (hibrid/e thellë dhe hibrid/e cekët) që dallojnë bazën e asetëve fizike me bazën me të cilën ngarkohen tarifat për **KOSTT** dhe **KEK**.

Fig. 2 Kyçja hibrid/e thellë





Fig. 3 Kyçja hibrid/e cekët



Baza e Aseteve të Operimit dhe Mirëmbajtjes (O&M) të KOSTT përbën të gjitha asetet e transmisionit. Megjithatë, disa nga këto asete do t'i kenë tarifën e operimit dhe mirëmbajtjes të paguara nga **Aplikuesi** përmes taksave të tyre të kyçjes. Pjesa e tarifës për O&M do të tarifohet në baza vjetore nga KOSTT për Aplikuesin gjatë tërë jetgjatësisë së

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit <i>ver. 2.6</i>	DT-KO-001 <i>faqe 12</i>
---	---	------------------------------------

aseteve. Pas një kohe, varësisht nga zhvillimi i Rrjetit të Transmisionit në lidhje me kyçjen përkatëse, do të jetë çështje e vendimit të ZRrE-së që për pjesën në vazhdim të jetëgjatësisë së aseteve tarifa për O&M të kalojë përmes tarifës TUoS.

Taksat për kyçje aplikohen ndaj **kyçjeve të reja** ose rritjes së kapacitetit të kyçjeve ekzistuese në pajtim me kërkesat ligjore.

3.3 Kyçjet Emergjente

Kur për shkak të rrethanave të paparashikuara është e nevojshme të sigurohet kyçje emergjente në transmision (dmth. jashtë shkallës kohore në Kodin e Kyçjes) atëherë do të aplikohet si më poshtë:

- Derogimin nga Kodi i Kyçjes që për këtë Metodologji të Taksave për Kyçje duhet ta jap **ZRrE**-ja;
- **KOSTT** do të jap vlerësimin më të mirë të kostos;
- **Aplikuesi** do ta paguaj këtë vlerësim në paradhënie;
- Kostoja e vërtetë do të rekonsiliohet pas rastit;

3.4 Operimi dhe Mirëmbajtja

Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes për **Asetet Direkte** dhe **Asetet e Infrastrukturës së Re** duke përfshirë edhe **Asetet e Përforsimit të Infrastrukturës** ekzistuese ,do të ngarkohen (tarifohen) në baza vjetore. **KOSTT** do të tarifoj aplikuesin në baza vjetore për kostot e ndërlidhura me O&M të aseteve të kyçjes përgjatë gjithë jetëgjatësisë së aseteve. Tarifa për operim dhe mirëmbajtje për secilin vit do të jetë 3.5% e **Vlerës së Aseteve Ekuivalente Moderne**.

Kohë pas kohe Rregullatori mund të shqyrtoj implementimin e O&M në një pikë të caktuar të kyçjes dhe varësisht nga gjendja e ardhshme e rrjetit në lidhje me atë kyçje, mund të vendosë që të njohë këto kosto si kosto të sistemit dhe t'i kalojë në tarifën TUoS. Kjo do të thotë se asetet e kyçjes atëherë do të jenë pjesë të bazës së aseteve të **KOSTT** për qëllim të kalkulimit të kostos së operimit dhe mirëmbajtjes.

Në rastet kur supozohet rreziku i mundshëm financiar, në marrëveshje me **Shfrytëzuesin** dhe me aprovim të Rregullatorit, **KOSTT** mund të ngarkoj pagesë të kapitalizuar për O&M. Kjo mund të jetë pagesë e lejuar e kapitalizuar për operim dhe mirëmbajtje në të ardhmen përgjatë jetëgjatësisë së aseteve. Shkalla reale e interesit prej 2.5% do të konsiderohet si norma e zbritjes (skontuese).

Tarifat për operim dhe mirëmbajtje do të ngarkohen njëjtë për të dyjat, Gjenerimin dhe Ngarkesën.

Për asetet e kyçjes të financuara nga donatorët nuk do të kërkohet pagesa për tarifën e operimit dhe mirëmbajtjes, megjithatë këto asete do të jenë pjesë e bazës e aseteve të

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 13</i>

KOSTT-it për qëllim të kalkulimit të kostos së operimit dhe mirëmbajtjes që do të mbulohen përmes tarifës TUoS.

3.5 Standardet e Kyçjes

Standardet e sigurisë në **Ofertën për Kyçje** do të jenë në pajtim me Kodin e Rrjetit dhe praktikën e mirë inxhinierike.

Pas aplikimit të **Aplikuesit, KOSTT** mundet me përvojën e vet të ofroj kyçje me standard më të ulët të sigurisë me terma dhe kushte përkatëse në **Ofertën për Kyçje**.

3.6 Asetet Direkte dhe të Veçanta të Kyçjes

Asetet Direkte janë asetet që janë drejtpërdrejtë të ndërlidhura me ndonjë Ofertë të caktuar për Kyçje. Këto asetë përfshijnë të gjitha elementet prej terminaleve të TL të transformatorëve deri tek **Asetet e Infrastrukturës së Re**. Kur një zbarë e kyçjes ka të dy kyçjet, të gjenerimit dhe shpërndarjes (ose konsumatori direkt), zbarat do të konsiderohen si asetë të sistemit dhe kufiri i **aseteve direkte** duhet të jenë qarqet e transformatorit të gjeneruesit dhe shpërndarjes deri në anën e izolatorëve të zbarës.

Kur është e nevojshme të ndahen **asetet direkte** në mes të **Shfrytëzuesëve** përfshirë edhe asetet nga paragrafi paraprak, kjo duhet të bëhet në bazë të **kapacitetit të kyçjes** së tyre.

Vlerësimi fillestar i kostos së **Aseteve Direkte** dhe **Aseteve të Infrastrukturës së Re** do të bazohet në njohurit aktuale të **KOSTT** lidhur me blerjen e **Aseteve të Tensionit të Lartë** dhe kostos së ndërtimit që aplikohet në Kosovë. Vlera finale e kostos së **Aseteve Direkte** dhe **Aseteve të Infrastrukturës së Re** do të jetë rezultat i procesit të tenderit për blerje nga **KOSTT**.

Figurat me shembuj janë dhënë në Shtojcën 1.

3.7 Përforcimi i Infrastrukturës

Në pajtim me Kodin e Rrjetit dhe praktikën e mirë dhe të matur inxhinierike **KOSTT** do të vlerësoj nivelin e kërkuar të përforcimit të transmisionit për cilindo **aplikacion për kyçje**.

Vlerësimi fillestar i kostos së përforcimit të infrastrukturës do të bazohet në njohurit aktuale të **KOSTT** për blerjen e **Aseteve të Tensionit të Lartë** dhe kostos së ndërtimit që aplikohet në Kosovë. Vlera finale e kostos së përforcimit të infrastrukturës do të jetë rezultat i procesit të tenderit për blerje nga **KOSTT**.


Ky vlerësim është i kufizuar në Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Neni 8.6:

“Nuk do të aplikohet asnjë taksë për përforcimin e rrjetit ekzistues nëse kërkesa për ngarkesë të re ose për rritje nuk kalon 3 % të kapacitetit ekzistues efektiv në pikat relevante në rrjet; dhe përforcimi i kryer në më shumë se një nivel të tensionit mbi tensionin e kyçjes”.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 14</i>

Për mënjanim të dyshimit pika e kufirit ndërmjet **Aseteve Direkte** dhe **Aseteve të Infrastrukturs së Re** është ana e nënstacionit të lëshuesve nga linja, siç është shënuar me ngjyrë tjetër në figurën 4. Kjo nuk do të thotë kufiri komercial i gjeneruesit, shpërndarjes ose konsumatorit me rrjetin e transmisionit.

Fig. 4 Pika e kufirit – **Asetet Direkte, Asetet e Infrastrukturs së Re** dhe Infrastruktura Ekzistuese



Shembuj tjerë figurativ janë dhënë në Shtojcën 1.

3.8 Përgjegjësit e Kyçjes dhe Taksat

Aplikacioni për Kyçje do të theksoi **Palën Përgjegjëse për Kyçje** që preferon **Aplikuesi** e cila do të jetë përgjegjëse për procesin e tenderimit dhe ndërtimit të kyçjes. Kjo palë mund të jetë **Aplikuesi** apo **KOSTT-i**:

- Nëse **Aplikuesi** është **Palë Përgjegjëse për Kyçje** atëherë:
 - **KOSTT** përgatitë Termat e Referencës dhe specifikimet teknike për **Asetet e Tensionit të Lartë**
 - **Aplikuesi** përgatit dosjen e tenderit dhe shpall tenderin;
 - **Aplikuesi** përzgjedh fituesin e tenderit, me aprovim të **KOSTT-it**
 - **Aplikuesi** do të paguajë koston tenderuese si dhe koston e kontratës;
 - **Aplikuesi** merr përgjegjësinë për ndërtimin dhe instalimin e **Aseteve të Tensionit të Lartë**;
 - **Aplikuesi** merr përgjegjësitë për sigurimin lejeve të nevojshme konform ligjeve të Kosovës ne fuqi,
 - **KOSTT** merr përgjegjësinë e komisionimit dhe lëshimit në operim të Aseteve të Tensionit të Lartë **Aplikuesi** merr përgjegjësinë për kryerjen e testimit të

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit <i>ver. 2.6</i>	DT-KO-001 <i>faqe 15</i>
---	---	------------------------------------

Aseteve të Tensionit të Lartë, ndërsa **KOSTT** merr përgjegjësinë për aprovimin e atyre testeve

-
- **Aplikuesi** paguan **Koston Inxhinierike** për **KOSTT**-in

- Nëse **KOSTT** është **Palë Përgjegjëse për Kyçje** atëherë:
 - **KOSTT** përgatitë Termat e Referencës dhe specifikimet teknike për **Asetet e Tensionit të Lartë**;
 - **KOSTT** përgatit dosjen e tenderit dhe shpall tenderin;
 - **KOSTT** dhe **Aplikuesi** përzgjedhin fituesin e tenderit;
 - **Aplikuesi** do të paguajë koston tenderuese si dhe koston e kontratës;
 - **KOSTT** merr përgjegjësitë për sigurimin lejeve të nevojshme konform ligjeve të Kosovës në fuqi,
 - **KOSTT** merr përgjegjësinë për: ndërtimin, instalimin, testimin, komisionimin dhe lëshimin në operim të **Aseteve të Tensionit të Lartë**.
 - **Aplikuesi** paguan **Koston Inxhinierike** për **KOSTT**-in

Është e mundur që të kemi më shumë se një **Palë Përgjegjëse për Kyçje**. Në at rast do të aplikohet zgjidhje tjetër e bazuar në parimet e kësaj metodologjie.

- Me përfundimin e ndërtimit dhe periudhës garantuese , **KOSTT** do të marr pronësinë e **Aseteve të Tensionit të Lartë** . Trajtimi komercial i këtyre asetëve do të jetë i kushtëzuar nga politika rregullative.

KOSTT do të ngarkoj Taksën për Kyçje për **Aplikuesin** të përbërë nga kostot e paraqitura në Nenin 4.7 të kësaj Metodologjie, pa përfshirë **Taksën për Aplikim**, e cila caktohet para aplikimit. **Taksa për Aplikim** është bazuar në numrin e ditëve të punës dhe **Tarifës Standarde**, shembuj konkret janë paraqitur në Shtojcën 3 të këtij dokumenti.

4 Çështjet e Implementimit

4.1 Trajtimi i Barabartë

Në pajtim me Licencën e **KOSTT** të gjithë **Aplikuesit** do të trajtohen në baza jo diskriminuese, përveç nëse ka arsye të mirëfillta teknike për dallime. Kjo metodologji diferencon parimet e taksës së aplikuar për Gjenerim dhe taksës së aplikuar për Ngarkesë, si kategori të ndryshme të **Aplikuesëve**, kurse klasa e njëjtë e **Aplikuesit** do të ketë trajtim të barabartë sipas dispozitave të kësaj metodologjie dhe dokumenteve tjera ligjore.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 16</i>

4.2 Konfidencialiteti

I gjithë komunikimi ndërmjet një Aplikuesi dhe KOSTT është tërësisht konfidencial. KOSTT nuk do të diskutoj çështjet me palët e treta përveç nëse merr leje me shkrim nga Aplikuesi. Kjo përfshinë edhe Aplikuesit tjerë, aplikacionet e të cilëve janë dorëzuar afërsisht në kohë të njëjtë dhe për pozitë e njëjtë në rrjet.

ZRrE mund të jetë e përfshirë në çfarëdo kohe gjatë procesit të kyçjes, nga aplikimi deri në komisionimin e kyçjes.

4.3 Diskutimet Preliminare dhe Studimet e Dizajnit

Aplikuesit ftohen që të kenë diskutime fillestare me **KOSTT** për kyçjet potenciale. Si pjesë e këtyre diskutimeve **KOSTT** do të ofroj një vlerësim preliminar të koston për kyçjen potenciale. Këto diskutime preliminare nuk do të formojnë në vete një **Aplikim të Kyçjes**, por do të jenë nën konfidencialitet të plotë. Diskutimet e tilla preliminare do të jenë pa pagesë.

KOSTT është i gatshëm të kryej **Studimin e Dizajnit**. Kjo do t'u mundësoj **Aplikuesëve** të kuptojnë koston e kyçjes së propozuar pasi që të bëhet **Aplikimi për Kyçje**. **Studimi i Dizajnit** do të ndërmerret në baza kohore dhe materiale. Koha e stafit të **KOSTT**-it do të paguhet në **Taksën për Aplikim**. Aty ku **KOSTT** e sheh të nevojshme se duhet mbështetje e konsulencës së jashtme, kjo do të dakordohet me **Aplikuesin** i cili do të paguaj shpenzimet e konsulencës së jashtme.

4.4 Publikimi i Kostos

KOSTT dhe **ZRrE** do të publikojnë në ueb faqet e veta strukturën aktuale të **Taksave për Aplikim dhe Tarifën Standarde** për klasë të ndryshme të **Aplikuesëve** dhe **Kapaciteteve të Kyçjes** së tyre.

4.5 Aplikimi për Kyçje

Të gjitha **Aplikacionet për Kyçje** do të trajtohen në bazë të parimit i pari vjen i pari shërbehet. Një **Aplikues** mundet t'i dorëzoj **KOSTT**-it një **Aplikacion për Kyçje** për kyçjen e ngarkesës ose gjenerimit në Sistemin e Transmisionit, ose të rrisë kapacitetin e kyçjes ekzistuese. Kjo bëhet duke e kompletuar dhe dorëzuar një formë të **Aplikacionit për Kyçje** së bashku me pagesën e **Taksës për Aplikim**.

Aplikimi nga **Aplikuesi** do të nënkupton fillimin e planit kohor të kyçjes që kërkon nga **KOSTT** të përgjigjet me një **Ofertë për Kyçje** brenda **Afatit të fundit për Ofertë** që do të jetë:

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 17</i>

- 30 ditë
Kur janë mbajtur diskutime të suksesshme preliminare dhe studimet e dizajnit janë kryer.
- 90 ditë
Ky do të jetë gjithmonë rasti nëse nuk është kryer ndonjë studim i përshtatshëm i sistemit ose rasti kur është e nevojshme të tenderohet për përgatitje të studimit të dizajnit para paraqitjes(dorëzimit) së ofertës, ose kur nevojitet përforcim në nivelin e tensionit të lartë të rrjetit të transmisionit;

Për mënjanim të dyshimit ky është afati i fundit dhe realisht **KOSTT** do të përgjigjet sa më shpejtë që është e mundur.

Kur **Aplikuesi** dëshiron të implementoj kyçjen në disa faza kohore, atëherë **Aplikuesi** mund të vendos të implementoj vetëm fazën e parë me një **Aplikim për Kyçje** vetëm për atë fazë. Kjo nuk rekomandohet sepse pa dyshim që nuk do të jetë optimale. Më mirë është që të:

- Të aplikohet formalisht për fazën e parë dhe me informata për të gjitha fazat përfshirë edhe planin e pritur kohor. Kjo qasje është e përshtatshme kur fazat pasuese janë në varësi të rritjes së kërkesës; ose
- Formalisht të aplikohet për të gjitha fazat me planin kohor të preferuar për komisionimin e secilës fazë. Kjo qasje është e përshtatshme për një central prodhues ku gjeneratorët individual do të komisionohen në faza të caktuara të planit kohor.

Nëse **Oferta për Kyçje** pranohet dhe Marrëveshja për Kyçje nënshkruhet, **Taksa për Kyçje** duhet të paguhet nga **Aplikuesi** duke përfshirë **Taksën për Aplikim** e cila paguhet paraprakisht. –.

4.6 Studimi i Dizajnit

Pas pranimit të **Aplikacionit për Kyçje** me pagesën e **Taksës për Aplikim, KOSTT** do të kryej studim të dizajnit i cili do të përfshijë:

- Dizajnimin e **Aseteve Direkte** dhe **Aseteve të Infrastrukturës së Re**.
- Dizajnimin e **Aseteve të Përforcimit të Infrastrukturës** të Sistemit të Transmisionit.

4.7 Taksa e Kyçjes

Taksa e kyçjes do të përbëhet prej pesë ose gjashtë njësive të veçanta (varësisht nga aplikimi për kyçje të thellë apo të cekët):

1. **Taksa për Aplikim**
 - **Studimi i Dizajnit**, vlerësimi për **Koston Fillestare** dhe draftimi i Marrëveshjes për Kyçje,

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 18</i>

2. **Kostoja Inxhinierike**
 - është kostoja që paguhet nga **Aplikuesi** për **KOSTT**, varësisht prej përgjegjësive dhe aktiviteteve të tij për procesin e tenderimit dhe ndërtimit të kyçjes;
3. **Kostoja e Aseteve të Kyçjes Direkte** dhe kostoja e **Aseteve të Infrastrukturës së Re**
 - Kostoja e blerjes dhe ndërtimit të **Aseteve të Kyçjes Direkte** dhe **Aseteve të Infrastrukturës së Re**;
4. **Kostoja e Përforcimit të Infrastrukturës**
 - Kostoja e blerjes dhe ndërtimit të **Aseteve për Përforcimin e Infrastrukturës**,
5. **Kostoja për Kompenzim**
 - Kosto që ndërlidhet me pagesën për qasje në tokë dhe për dëmet eventuale gjatë implementimit të projektit
6. **Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes (O&M)**
 - Kostot e ndërlidhura me operimin dhe mirëmbajtjen e kyçjes

Taksa për Aplikim (komponenta 1) paguhet me **Aplikimin për Kyçje**. Pagesa e **Koston Inxhinierike** dhe kostot e Aseteve (Komponenta 2, 3, 4 dhe 5) paguheshin ashtu siç është specifikuar në **Marrëveshjen për Kyçje**, dhe është parakusht për fillimin e punës. Tarifa e parë O & M (Komponenta 6) paguhet kur Asetet janë dorëzuar në pronësi të **KOSTT-it**, dhe më pastaj në 12 intervale mujore apo një herë në vit.

Lidhur me **Koston Inxhinierike**, **KOSTT-i** mund të kërkojë një depozitë, që nuk tejkalon 10.000€, për pagesë, kjo depozitë të kompensohet kur **Aplikuesi** paguan kostot e **Aseteve të Kyçjes Direkte** apo **Aseteve për Përforcimin e Infrastrukturës**.

KOSTT ka të drejtë të kërkojë pagesën e detyrimit për anulim (përfundim) të kyçjes, por do të heq dorë nga kjo e drejtë derisa anulimi (përfundimi) të ndodh realisht.

4.8 Oferta për Kyçje

KOSTT do të paraqes një **Ofertë për Kyçje** për **Aplikuesin** brenda **Afatit të fundit për Ofertë**. Kjo **Ofertë për Kyçje** mbetet e vlefshme për 45 ditë.

Oferta për Kyçje duhet të përmbajë rezultatet e studimit të **Dizajnit Fillestar, Kapacitetin e Kyçjes, Datën e Kyçjes, Palën Përgjegjëse për Kyçje, Taksën për Kyçje** që do të paguhet dhe **Marrëveshjen e propozuar për Kyçje**.

Ku **Aplikimi për Kyçje** shtrihet në një periudhë kohore të ndarë në faza, **Oferta për Kyçje** do të merr këtë në konsideratë.

4.9 Marrëveshja për Kyçje

Kjo marrëveshje përfshinë:

- **Palën Përgjegjëse për Kyçje;**
- **Kapacitetin për Kyçje;**
- **Datën e Kyçjes;**

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit <i>ver. 2.6</i>	DT-KO-001 <i>faqe 19</i>
---	---	------------------------------------

- Kushtet teknike të Kodit të Rrjetit të ndërlidhura me kyçjen;
- Procesin e kyçjes përfshirë planin kohor dhe **Studimin e Dizajnit**
- **Taksën për Kyçje** dhe pagesën e saj;
- Operimin në vazhdim të kyçjes, dhe
- Kushtet e shfrytëzimit të sistemit

Do t'i bashkëngjitet **Ofertës për Kyçje** dhe duhet të nënshkruhet brenda 15 ditëve pas pranimit të **Ofertës për Kyçje**.

4.10 Refuzimi për Kyçje

KOSTT do të mund të refuzoj një kyçje vetëm nëse ka arsye teknike për një gjë të tillë, siç përshkruhet në Kodin e Rrjetit – Kodin e Kyçjes dhe kodet tjera teknike. Duke pasur parasysh se **Aplikuesi** duhet të paguaj paraprakisht, nuk duhet të ketë asnjë arsye financiare për refuzim.

4.11 Dështimi i Kyçjes

Cilado palë (përfshirë Operatorin e Shpërndarjes) që dëshiron një **kyçje të re** në Sistemin e Transmisionit duhet që paraprakisht të paguaj **Taksën e Kyçjes**. Prandaj nuk ka rrezik direkt për **KOSTT** nëse projekti nuk përfundon dhe kyçja mbetet e pa shfrytëzuar.

Nëse projekti anulohet në gjysmë të procesit të ndërtimit disa kosto mund të kursehen duke e ndaluar punën e mëtutjeshme. Për më shumë nëse asetet të cilat janë blerë mund të ripërdoren do të ketë zbritje kur ato të ripërdoren.

4.12 Avancimet e Kyçjes (Rritja e kapacitetit)

Kur kërkesa e pikut në një kyçje është **3%** më e madhe se kapaciteti i sistemit, **KOSTT** ka të drejtë të avancoj kyçjen. **KOSTT** zbaton parimin e modifikimit (avancimit) material varësisht prej vend-kyçjes duke shfrytëzuar taksë përkatëse.

Avancimet e imponuara nga sistemi do të iniciojnë taksë të reja. P.sh. nëse një gjenerator kyçet afër lokacionit dhe nivelet e defekteve ngriten ashtu që ndërprerësit ekzistues nuk janë më të sigurtë, **Shfrytëzuesi** ekzistues i Sistemit do të avancoj ndërprerësit e vet dhe do të paguaj për avancimin e ndërprerësve të **Aseteve Direkte**.

4.13 Asetet e Paguara nga Donatorët

Ku **Asetet Direkte**, **Asetet e Infrastrukturës së Re** ose **Asetet e Përforcimit të Infrastrukturës** paguhen nga donatori, këto do të trajtohen si pjesë e sistemit kryesor të transmisionit të **KOSTT**.

Kjo do të thotë se **KOSTT** do t'i rikuperoj shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes të ndërlidhura me këto asete nëpërmjet tarifës TUoS.

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit <i>ver. 2.6</i>	DT-KO-001 <i>faqe 20</i>
---	---	------------------------------------

4.14 Zbritjet

Kur një **Aplikues** dëshiron të kyçet në **Asetet Direkte** ekzistuese, ose të shfrytëzoj **Asetet e Përforcimit të Infrastrukturës**, brenda shtatë viteve të ndërtimit origjinal, **Shfrytëzuesi** ekzistues do ketë të drejtë në kompensim (kthim) nga **Aplikuesi**.

Ky kompensim (kthim) duhet të jetë proporcional me pjesën e aseteve të kyçjes origjinale të shfrytëzuara nga **Aplikuesi**. Do të bazohet në një ndarje sipas ngarkesave maksimale të **Aplikuesit** dhe të **Shfrytëzuesit**.

4.15 Anulimi (Përfundimi) i Kyçjes

Kur një **Aplikues** dëshiron të anuloj Marrëveshjen e Kyçjes ai duhet të njoftoj **KOSTT**-in një vit më herët.

KOSTT ka të drejtë në pagesë për punët inxhinierike që të siguroj lokacionin. Nëse asetet janë të përdorshme ato mund të kompensohen (kthehen) kur të përdoren.

4.16 De-energizimi

De-energizimi i kyçjes përfshirë izolimin dhe mbylljen nuk llogaritet si anulim (përfundim) i Marrëveshjes për Kyçje.

Kur një **Shfrytëzues** de-energizohet për shkak të dështimit të paguaj ose për mos pajtueshmëri me Kodin e Rrjetit, Marrëveshja e Kyçjes mbetet në fuqi dhe tarifatat TUoS ende duhet të paguhet, përfshirë edhe tarifën për operim dhe mirëmbajtje. Të vëhet re se tarifatat aktuale tërësisht bazohen në MW respektivisht në MWh të furnizuar, kjo mund të ndryshoj gjatë kohës sa Marrëveshja për Kyçje është në fuqi.

Një **Shfrytëzues** me asete të reja të kyçjes mundet të kërkoj që transformatorët e vet të de-energizohen për një periudhë të caktuar pas **Datës së Kyçjes**. Kjo kërkesë do zbatohet, por deri në atë masë sa ka tarifa TUoS të cilat do të paguhet edhe më tutje, përfshirë edhe tarifatat për operim dhe mirëmbajtje. Sidoqoftë, **KOSTT** në kushte normale do të energjizoj përforcimin e infrastrukturës dhe asetet tjera direkte.

Një **Shfrytëzues** mundet të kërkoj që transformatorët e vet të de-energizohen për një periudhë kohore (për shembull një pronar i tokës së fabrikës, fabrikën të cilën askush nuk e përdorë). Kjo kërkesë do zbatohet, por deri në atë masë sa ka tarifa TUoS të cilat paguhet edhe më tutje, përfshirë edhe tarifatat për operim dhe mirëmbajtje.

4.17 Ankesat

Cilido **Aplikues** ka të drejtë të ankohet në **ZRrE** për **Ofertën për Kyçje** sipas “Rregullit për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë”.

Shtojca 1: Shembujt përmes Figurave të Kyçjeve të Reja

Fig. A1.1




Fig. A1.2




Fig A1.3




Fig. A1.4




Fig. A1.5 Përforcim i pastër i thellë





Fig. A1.6 Shembull i Zbritjes



Shtojca 2: Forma e Aplikacionit për Kyçje

FORMA E APLIKACIONIT PËR KYÇJE – NGARKESË “N”

Kur të përfundohet dërgoje këtë aplikim:

Personi kontaktues¹

KOSTT

Rr. Iljaz Kodra p.n.

10000 Prishtinë

Kosovë

Aplikuesi	
Personi kontaktues	
Kontakt detajet e Aplikuesit	
Lokacioni i propozuar i nënstacionit <i>Bashkëngjit bartën e lokacionit</i>	
Data e kërkuar e përfundimit	
Numri i propozuar i transformatorëve <i>Bashkëngjit skemën e planimetrisë së propozuar të nënstacionit</i>	
Ngarkesa maksimale për tu furnizuar (MW) brenda 10 viteve nga koha e kyçjes	
Faktori maksimal i ngarkesës induktive dhe i ngarkesës kapacitive	
Pala Përgjegjëse për Kyçje	
Ju lutem paraqitni informatat relevante teknike si kërkohet në Kodin e Rrjetit	
Ju lutem paraqitni informata tjera relevante të cilat do të ndihmojnë në studimin e dizajnit	
Bashkangjitur Taksa e	Po

¹ Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me Aplikacionin për Kyçje lutem kontaktoni personin e 2^{te} kontaktues

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 25</i>

Aplikimit	
-----------	--

Unë i poshtë shënuari me këtë konfirmoj se të gjitha informatat e paraqitura më lartë janë të sakta në bazë të njohurisë time më të mirë. Unë do të njoftoj **KOSTT** për çfarëdo ndryshimi të madh të këtyre të dhënave sa më parë që të jem në dijeni për atë.

Emri dhe Pozita: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

FORMA E APLIKACIONIT PËR KYÇJE – Gjenerimi “G”
Kur të përfundohet dërgoje këtë aplikim:

Personi kontaktues²

KOSTT

Rr. Iljaz Kodra pn

10000 Prishtinë

Kosovë

Aplikuesi	
Personi kontaktues	
Kontakt detajet e Aplikuesit	
Lokacioni i propozuar i nënstacionit <i>Bashkëngjit hartën e lokacionit</i>	
Data e kërkuar e përfundimit	
A është kërkesa për kyçje në faza <i>Bashkëngjit detajet e planit kohor</i>	
Tipi i Karburantit	
Nëse është Hidro bashkëngjit detajet e plota hidrologjike Nëse është me Erë bashkëngjit informatat meteorologjike	
Numri i propozuar i gjeneratorëve dhe madhësitë (MW) <i>Bashkëngjit skemën e planimetrisë së nënstacionit</i>	
Gjenerimi maksimal (MW)	
Gjenerimi maksimal stabil (MW)	
Maksimumi i MVA dhënje dhe MVA marrje	
Pala Përgjegjëse për Kyçje	
Ju lutem paraqitni informatat relevante teknike si kërkohet në	

² Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me Aplikacionin për Kyçje lutem kontaktoni personin e 2^{te} kontaktues

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 27</i>

Kodin e Rrjetit	
Ju lutem paraqitni informata tjera relevante të cilat do të ndihmojnë në studimin e dizajnit	
Bashkangjitur Taksa e Aplikimit	Po

Unë i poshtë shënuari me këtë konfirmoj se të gjitha informatat e paraqitura më lartë janë të sakta në bazë të njohurisë time më të mirë. Unë do të njoftoj **KOSTT** për çfarëdo ndryshimi të madh të këtyre të dhënave sa më parë që të jem në dijeni për atë.

Emri dhe Pozita: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

	Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit	DT-KO-001
	<i>ver. 2.6</i>	<i>faqe 28</i>

Shtojca 3: Taksa për Aplikim, Tarifa Standarde dhe Kostoja Inxhinierike

Tabela e mëposhtme tregon shembujt tipik të numrit të ditëve të nevojshme për procesimin e aplikimit për kyçje në Sistemin e Transmisionit.

Nr.	Lloji	Fuqia në MW	Numri i ditëve
1.	Ngarkesë	≤20	8
		>20 dhe ≤100	12 ose (*)
		>100	(*)
2.	Gjenerator	≤ 20	12
		>20 dhe ≤100	20 ose (*)
		>100	(*)

*paraqet studimin e nevojshëm të fizibilitetit, kostoja e të cilit përfshinë çmimin e kontraktuar + tarifën administrative

Numri i pritur i ditëve është i përafërt dhe është i varur nga lokacioni dhe vështirësia e kyçjes. Numri aktual i ditëve të punës do të tarifohet me Tarifën Standarde duke përfshirë edhe punën në terren.

Tarifa Standarde është tarifa që kalkulohet në baza ditore prej 100€ për ditë pune.

Taksa për Aplikim do të llogaritet si më poshtë:

Taksa për Aplikim = Tarifa Standarde x numri i ditëve të punës.

Kostoja Inxhinierike do të kalkulohet si më poshtë:

- 1.5% e koston së **Aseteve të Tensionit të Lartë** kur **Aplikuesi** është **Pala Përgjegjëse për Kyçje**
- 5% e koston së **Aseteve të Tensionit të Lartë** kur **KOSTT** është **Pala Përgjegjëse për Kyçje**

	<p align="center">Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit</p>	<p align="center">DT-KO-001</p>
	<p align="center"><i>ver. 2.6</i></p>	<p align="center"><i>faqe 29</i></p>

Shembull:

Nëse supozojmë të kemi një **Aplikacion për Kyçje** në Rrjetin e Transmisionit, lloji i të cilit është Ngarkesë me kapacitet prej 80 MW, kostoja finale për implementim e **Aseteve të Tensionit të Lartë** do të kushtoj 2 mil € atëherë:

Tarifa Standarde = 100 €

Taksa për Aplikim = 100 € x 12 ditë pune = 1200 €

Nëse **Palë Përgjegjëse për Kyçje** është **Aplikuesi** :

Kostoja Inxhinierike = 2 000 000 € x 0.015 = 30 000 €

Nëse **Palë Përgjegjëse për Kyçje** është **KOSTT**:

Kostoja Inxhinierike = 2 000 000 € x 0.05 = 100 000 €

(Fund i dokumentit)